



DIETA SHPK

FABRIKE PRODHIMI MIELLI

LOERMA SH.P.K

ALUSH LLESHANAKU
ELBASAN
MYSLYM SHYRI
TIRANE

+355 69 20 46 660

www.loerma.com

5/5/2017



PASQYRA E LËNDËS:

- 1. KUADRI LIGJOR, RREGULLATOR**
- 2. PËRSHKRIM I MJEDISIT**
- 3. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT**
- 4. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS**
- 5. MASAT PËR MINIMIZIMIN DHE MONITORIMIN E NDIKIMEVE NË**

MJEDIS

KUADRI LIGJOR, RREGULLATOR

- Ligji Nr 10431, datë 09.06. 2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit".
- Ligji Nr 10440, datë 07 .07. 2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis".
- Ligji Nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit".
- Ligji Nr.8897, datë 16.05.2002, "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja".
- Ligji Nr.9115, datë 24.7.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura"
- Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006, "Për mbrojtjen e biodiversitetit"
- Ligji Nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve".
- Vendim Nr. 686, datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e afateve për zhvillimin e procedurës së VNM-së dhe procedurës së transferimit të vendimit të deklaratës mjedisore".
- Vendim Nr. 313, datë 09.05.2012 "Për rregulloren e mbrojtjes së publikut nga shkarkimet në mjedis".
- Vendim Nr.1189, datë 18.11.2009 "Për Rregullat dhe Procedurat për Hartimin dhe Zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit".
- Vendimi Nr.247, datë 30.04.2014 "Për tërheqjen e mendimit të publikut në vendimmarrjen për mjedisin".
- Vendim Nr. 123, datë 17.2.2011 "Për menaxhimin e zhurmave"
- Vendim Nr. 177, datë 6.3.2012 "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre"
- Vendim Nr. 177, datë 31.3.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengeta dhe kriteret e zonimit të mjedisve ujore pritëse".
- Vendim Nr. 435, datë 12.9.2002 "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë.

Raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, është mbështetur në legjislacionin mjedisor si më lartë dhe ka për qëllim që të identifikojë, parashikojë dhe monitorojë ndikimin e këtij aktiviteti në mjedis. Kuadri ligjor për VNM-në sigurohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga dy ligje për mjedisin në Shqipëri; Ligji "Për Mbrojtjen e Mjedisit" dhe Ligji "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis". VNM është një proces sistematik për të përcaktuar dhe vlerësuar efektet apo ndikimet në mjedis të një veprimi apo projekti të caktuar. Në një situatë normale, ky proces aplikohet përpara se të merret vendimi dhe të fillojnë angazhimet për realizimin e projektit. Por sidoqoftë, dhe në çdo kohë, efektet sociale, kulturore dhe shëndetësore janë konsideruar si pjesë integrale e VNM-së. Kujdes i veçantë i kushtohet praktikave të VNM-së për të parandaluar dhe minimizuar efektet e mundshme negative të veprimeve të ndermarra. Qëllimi i VNM-së është informues (të japë informacion për pasojat mjedisore të studimeve të propozuara) dhe këshillues (përmirësim nga pikëpamja mjedisore të propozimit dhe projektit).

PËRSHKRIM I MJEDISIT

Zona Gjeografike: Bashkia e re e Elbasanit kufizohet në veri me bashkinë Tiranë, në lindje me bashkinë Librazhd, në jug-lindje me bashkinë Prrenjas, në jug-perëndim me bashkinë Gramsh dhe në perëndim me bashkitë Cërrik dhe Peqin. Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Elbasanit.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, kjo bashki numëron 141,714 banorë me densitet prej 162.51 banorë për km², ndërsa sipas Regjistrimit Civil ajo numëron një popullsi prej 205,892 vetësh dhe densitet prej 236.11 banorë për km². Bashkia e Elbasanit ka një sipërfaqe prej 872,03 km².

Kjo bashki përbëhet nga 13 njësi administrative, të cilat janë: Elbasan, Labinot-Fushë, Labinot-Mal, Gjinar, Shushicë, Gjergjan, Funar, Shirgjan, Tregan, Gracen, Bradashesh, Zavalinë dhe Papër. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Elbasanit dhe qarkut të Elbasanit. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 116 fshatra.

Fabrika e miellit DIETA ushtron veprimtarinë e prodhimit të miellrave për prodhimin e bukës dhe atë ushqimore në zonën e fshatit Kuqan të komunës Shirgjan, Qarku Elbasan.

Komuna Shirgjan ndodhet në pjesën qendrore të Shqipërisë, në juglindje të qytetit të Elbasanit. Është një zonë tipike fushorë-kodrinore. Fushat kanë lartësinë nga 80-100 m mbi nivelin e detit dhe kanë emrat përkatës si fusha e Shirgjanit, e Kuqanit, Bathës Jagodinë etj. Gjithashtu dhe kodrat janë Kodra e Mjekësit, Kodra e Kryezjarrthit, Kodra e Kuqanit. Bimësia natyrore përfaqësohet nga shkurret, pyjet dushku, pisha e kultivuar. Në këtë komunë ndodhet Uzina e Mjekësit, uzinë për prodhimin e municioneve e cila para viteve 90 ka pasur një numër të konsiderueshëm punëtorësh. Sot ajo vepron si një uzinë për demontimin e armëve. Popullsia është autoktone e shtrirë me një sip. 21.3 km² me një numër prej 9421 banorësh. Dega kryesore e ekonomisë është bujqësia dhe prodhimi i drithrave. Sipërfaqja bujqësore është 1431 ha dhe sipërfaqja e pyjeve dhe kullotave është 181 ha. Sot aty veprojnë 106 biznese.

Vëndi ku zhvillohet veprimtaria është zonë rurale, që do të thotë që vlerat floristike dhe faunistike brënda kësaj sipërfaqe ka humbur prej kohësh për efekt tjetërsimit të natyrës së terrenit (duke e kthyer atë terësisht në tokë bujqësore)

Zona ku zhvillohet veprimtaria është një hapësirë natyrore e cila nuk gëzon ndonjë status të vecantë të mbrojtjes së natyrës apo vlera të vecanta si habitat për specie me statut të mbrojtur, endemikë etj.

Bimësia përreth I përket asaj mesdhetare ku dominojnë shkurret. Ndërsa përta I përket faunës zona përreth nuk shquhet për lloje të ndryshme kafshësh pasi është afër zonave të banuara. Megjithatë duhet pranuar prania e leujve dhe dhelprës së kuqe por më shumë në pjesën kodrinore. Ndërsa përta I përket shpendëve të egër në zonë hasen harabelorë Paser domesticus, Garelida cristata, Milaria calandra etj.

Aktiviteti zhvillohet në një zonë të kufizuar e cila duke qenë në afërsi të rrugës kryesore nuk ka lejuar në të shkuarën folezimin e specieve të mësipërme në afërsi të saj kështu që edhe veprimtaria jonë nuk komprometon jetesën e specieve.

Në blegtori komuna shquhet për rritjen e lopëve, të derrave, të imtave e shpendëve.

Në zonën ku gjendet fabrika, burimet nëntokësore janë në thellësi me mbi 20m. gjeologjia e zonës përfaqësohet nga depozitime të Kuartenarit me natyrërreth 18 km. gjerësia e shtresës ndryshon nga 1 km në 7 km e para në lindje të Krastës deri në 5 km në perëndim të Krastës dhe të qytetit të Elbsanit. Trashësia e shtresës është mbi 50 m në pjesën lindore, ndërsa në pjesën perëndimore është mbi 100 m. mendohet se potencia në pjesën perëndimore është 180-200m ndërsa në lindje 80-100m. vetëm në krastën e vogël shtresa ujembajtëse e zhavorreve aluviale ka trashësi 10.3m. litologjia e shtresës ujembajtëse përfaqësohet terësisht nga zhavore të trasha gëlqërore, ultrabazikësh e më pak ranore me përmbajtje deri në 20% rërë.

Nga analiza e informacionit shumë vjekar del se rrjedhja ka një shpërndarje stinore e cila kulmon në stinën e pranverës (stina me më shumë ujë) me 35-40% të rrjedhjes vjetore. Më pas vjen dimir me 31-35%, vjeshta me 14-16% dhe vera me 13-15%. Nëse I referohemi shpërndarjes mujore, muaji me më shumë ujë është prilli me 10-14% të rrjedhjes vjetore dhe muajimë me pak ujë është gushti me 1.9-2% të saj.

Ppërshkrimi I elementëve klimatikë të zonës ku është vendposur fabrika I referohet studimit mbi vecoritë hidrometeorologjike dhe mjedisore të qytetit të Elbasanit I përgatitur nga Insituti I Hidrometeorologjisë.

Zona e Elbasanit , sipas ndarjse klimatike të Shqipërisë, bën pjesë në zonën mesdhetare kodrinore dhe nën-zonën mesdhetare kodrinore qëndrore. Larmia e formave të relievit dhe shtrirja e gjerë very-jug e kësaj nën zone ndikojnë në regjimin e elementëve klimatikë. Temperature mesatare e ajrit varion nga 6.7 °C në janar deri në 23.4 °C në korrik. Temperaturat mesatare maksimale varion nga 11 °C në janar deri në 31.2 °C në korrik. Temperaturat mesatare minimale varion nga 2.2 °C në janar deri në 20 °C në korrik.

Vëndi ku ndodhet fabrika dhe zhvillohet veprimtaria nuk cënon paisazhin përreth dhe topografinë e zonës për faktin se në zonën ku gjendet nuk egzistojnë vlera të vecanta arkitektonike, historike apo arkeologjike.

PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Fabrika e miellit “DIETA” SHPK ushtron veprimtarinë e prodhimit të miellrave për prodhimin e bukës dhe atë ushqimore në zonën e fshatit Kuqan. Sipërfaqja në administrim nga shoqëria është 1671 m² nga e cila 971.4 m² përbëhet nga ndërtesa e zhvillimit të aktivitetit.

I tërë objekti dhe trualli për rreth tij janë në pronësi të Z.Albert Shopi I cili ja ka lënë me qera Z.Klajdi Shopi me kontratë të rregullt qera marrjeje.

Kufizimet e pasurisë paraqiten në tabelën më poshtë.

| | | | | | |
|--|-----------------|-----------------|-----------------|-----------------|----------------|
| | Pasuri 63/17 | Pasuri 63/18 | Pasuri 63/19 | Pasuri 63/21 | Pasuri 63/7 |
|--|-----------------|-----------------|-----------------|-----------------|----------------|

DIETA SHPK PRODHIM FABRIKE E PRODHIMIT TE MIELLIT

| | Sip 32.6 m ² | Sip 32.6 m ² | Sip 45 m ² | Sip 35 m ² | Sip 712 m ² |
|----------|-------------------------|-------------------------|-----------------------|-----------------------|------------------------|
| Veri | 63/18 | 63/19 | 63/20 | 63/10 | 63/10 |
| Lindje | 63/20 | 63/20 | 63/20 | 63/10 | 199 |
| Jug | 63/12,63/14 | 63/17 | 63/18 | 63/20 | 63/5 |
| Perëndim | 63/20 | 63/20 | 63/20 | 63/10 | 63/4,63/6 |

Lënda e parë që vjen nga vendi apo importi që në rastin konkret janë drithërat e ndryshme si misri, gruri, thekra, elbi etj vijnë të shoqëruara me fletë analize e cila përfaqëson cilësinë e lëndës që do të përdoret.

Pasi lënda e parë është grumbulluar në magazinimin e lëndëve të para, futet në bunkerin e furnizimit të linjës I cili mbushet herë pas here periodikisht sipas nevojave të prodhimit.

Nga bunkerin I furnizimit me anë të një shneku, materiali që do të bluhet misër/grurë kalon në pajisjen shoshitëse nga ku I largohen papastërtitë që shoqërojnë lëndën e parë që mund të jenë në trajtë pluhurash dhe nëpërmjet sistemit të thithjes kalohen për në ciklon së bashku me ajrin dhe ato që janë të mëdha që përfaqësohen nga mbeturina mekanike (masurret e misrit) kalojnë nga poshtë dhe grumbullohen në thaës për tu trajtuar si mbetje.

Më pas lënda e parë misri/gruri kalohen në pajisjen e heqjes së mbetjeve inerte të ngurta me origjinë inorganike. Këto mbetje mblidhen në thasë të vecantë për ti dërguar në vend grumbullimit të tyre.

Për rritjen e shkallës së pastërtisë së lëndës së parë procesi vazhdon duke e kaluar këtë lëndë në trioriorin e pastrimit nga ku nga poshtë I hiqen papastërtitë e mbetura dhe që kanë një natyrë më të imët.

Nga trioriori përsëri misri apo gruri futet në një pastruese tjetër dhe më pas në një pastruese me elektro manjet për largimin e mbeturinave me natyrë metalike që mund të shoqërojnë lëndën e parë.

Më pas misrit I bëhet copëtimi paraprak në një pajisje copëtuese. Me anë të një elevator materiali I copëtuar kalohet në një linjë treshe e cila bën kalimin për përpunimin në secilën nga të treja linjat.

1. Fabrika Turke
2. Fabrika e vogël
3. Fabrika e madhe

Fabrika turke shërben për bluarjen e grurit. Pajisjet dhe makineritë janë paralele. Pasi misri I copëtuar dhe I pastruar kalon në sillozin e grumbullimit të tij e kalohet në një pajisje copëtuese ku bëhet thërrmim I mëtejshëm I tij në mënyrë që të hyjë në bluarsen me parametra sa më të arritura. Pas kalimit në copëtues misri tashmë I rritur për bluarje kalon në mullinjtë e bluarjes, mullinj në të cilën arrihen parametrat e tije sipas analizës sitore të kërkuar. Nga mulliri bluarjes , produkti tashmë I bluar por I pa përfunduar kalohet në plasticer, pajisje kjo që shërben për ndarjen e produkteve të trasha dhe të blujtura në dimensionin e duhur nga materiali I bluar.

Mbetjet e trasha dhe këto ndahen në plasticier në dy fraksione, fraksioni I imët I cili përthithet me vakum dhe riciklohet për në bluarje dhe fraksioni I trashëdhe ky rikthehet për në bluarje me vetë rrjedhje.

Nga plasticeri misri tashmë I kthyer plotësisht në mjellë kalon në procesin e sitosjes ku bëhet ndarja e nën produkteve ku mbetjet e trasha kalohen në një linjë me ato që dalin nga plasticeri ndërsa mielli kalon në sillosin e mjellit.

Nga sillosi I grumbullimit të miellit të bluar, mielli I grumbulluar nëpërmjet dy linjave kalon për ambalazhim dhe konkretisht:

1. Në ambalazhimin me thasë
2. Ambalazhim me qese

Duhet thekësuar se të treja linjat e bluarjes së miellit DIETA janë të pajisura me sistemin e thithjes dhe drejtimit të pluhurave nëpërmjet sistemit të filtrimit të ajrit me filtra, me bezë me mëngë. Një ventilator I fuqishëm është vënë në qendër të krejt sistemit dhe thith të gjitha pluhurat për ti dërguar në filtrate me mëngë.

Për largimin e pluhurave që përmbahen në ajrin gjatë proceseve teknologjike të përshkuara më sipër përdor sistemin e pastrimit në të thatë me filtra me mëngë (fabric filter). Në linjën e prodhimit të miellrave janë të instaluar dy impiante të pastrimit të ajrit nga pluhurat me pluhur kapësa.

Thithja e pluhurave dhe kapja e pluhurave me mënyrën e thatë me filtra me mëngë është teknika më e përhapur për evakuimin dhe pastrimin e pluhurave nga ajri.

Sistemet me filtra me mëngë kanë rendiment kapje të pluhurave që arrijnë në vlerat 99.0-99.5%. përqëndrimi në dalje të shkarkimit të ajrit I pluhurave, pas pastrimit në filtrate me mëngë, mund të arrijë deri në 5mg/Nm³

Lëndët e para kryesore për prodhimin e miellrave janë drithërat. Drithërat që përpunohen në fabrikën e miellit “DIETA” janë:

- ❖ Misër
- ❖ Grurë
- ❖ Thekër
- ❖ Elb

Burimet e furnizimit janë në përgjithësi nga importi por fabrika furnizohet dhe me drithëra me origjinë nga vëndi.

Fabrika e miellit “DIETA” është një konsumator relativisht mesatar I energjisë elektrike. Përdorimi kryesor I energjisë elektrike është për bluarjen, sitosjen dhe ambalazhimin e miellit dhe për vënien në lëvizje të motorëve dhe pajisjeve elektrike të ndryshme në linjat e prodhimit të miellit. Për nevoja furnizimi në fabrikë është instaluar një transformator.



IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS

Mjedisi është gjithmonë i prekur nga veprimtaritë e ndryshme që ushtrohen në të, por ndikimi mund të jetë i ndryshëm, kjo është e lidhur ngushtë me vetë llojin e veprimtarisë e cila mund të ketë impakt të drejtpërdrejtë, të tërthortë, të rëndësishëm apo mesatar i pranueshëm.

Aspektet mjedisore më të rëndësishme që lldhen me prodhimin e fabrikës së mjellit DIETA kanë të bëjnë kryesisht me shkarkimet në ajër, trajtimin e ujrave dhe prodhimin e mbetjeve të ngurta.

SHKARKIMET NË AJËR:

E tërë linja e prodhimit të miellit si dhe makineritë që realizojnë pastrimin, parabluarjen, ndarjen e fraksioneve, bluarjen, sitosjen dhe deri në ambalazhimin e miellit qoftë në thasë apo në masa janë procese që shoqërohen me prodhime pluhurash në ajër. Këto shkarkime përbëhen nga pluhura që kryesisht kanë natyrë organike dhe kanë të njëjtën përbërje si dhe të produktit të gatshëm. Kuptohet që I vetmi transportues I këtyre pluhurave në fabrikë është vetëm ajri.

Lënda e ngurtë e shpërndarë në ajër dhe të pa kontrolluar, me rënien në tokë, mund të jetë një burim që të ndikojë në tokë, ujëra dhe në mjedisn përreth

Procesi I bluarjes së drithrave është një proces I vazhduardhe ai zhvillohet pa pushim në afatin kohor gjatë të cilit punon fabrika.

Pluhurat konsiderohen si një prej ndotësve kryesorë të shkarkuar në ajër nga fabrika e miellit. Saisa dhe përbërja e pluhurave të prodhuar gjatë funksionimit të fabrikës, varen kryesisht nga cilësia e drithrave të përdorur për bluarje por edhe nga konfiguracioni I linjës dhe nga procedurat e punës së adoptuara. Pluhurat e prodhuara mund të jenë në nivele nga 10 në 15 kg/ton drith të bluar dhe ka një përmbajtje deri në 10-15 gr/Nm³ vëllim të thithur.

ZHURMAT:

Në fabrikën e miellit zotërues janë burimet e mëposhtëme të zhurmave:

- ❖ Procesi I shoshitjes së drithrave
- ❖ Procesi copëtimit paraprak të drithrave
- ❖ Mullinjtë e bluarjes
- ❖ Plasticeri
- ❖ Procesi I sitosjes

Niveli I zhurmave në linjë gjatë funksionimit të ajë shkon në parametrat 130-143 dB(A). fuqia specifike e transformatorit përcakton nivelet e lëshimit të zhurmave. Lëshimi I zhurmave në fabrikë është I vazhduar. Në dallim nga shkarkimet në ajër, trajtimin e ujrave dhe prodhimin e mbetjeve të ngurta për të cilat ka teknologji dhe informacione të mjaftueshme për të kryer

kontrollin dhe administrimin, për zhurmën njohuritë dhe metodat janë akoma të pamjaftueshme.

Në linjat e prodhimit të miellrave të fabrikës “DIETA” nuk janë kryer matje për të përcaktuar nivelin e zhurmave të emetuara nga pajisjet e sipërpërmendura.

MASAT PËR MINIMIZIMIN DHE MONITORIMIN E NDIKIMEVE NË MJEDIS

1.ZBATIMI I MASAVE TË MBROJTJES NË PUNË, TË MBROJTJES NGA ZJARRI JANË NË QËNDËR TË VEMËNDJES TË ADMINISTRATORIT DHE DREJTUESIT TEKNIK TË SUBJEKTIT. NË KUADËR TË KËTYRE MASAVE MUND TË PËRMENDIM :

- Shërbimet teknike dhe mirëmbajtjen e makinerive dhe pajisjeve.
- Instruktimin apo trajnimin e punonjësve mbi rregullat e shfrytëzimit të këtyre pajisjeve e makinerive, të rregullave të mbrojtjes në punë dhe të rregullave të mbrojtjes nga zjarri.
- Kontrollin shëndetsor të punonjësve një herë në vit.
- Pajisjen e punonjësve me veshjet normale të punës si dhe me mjete mbrojtëse individuale si syze, kufje, kapela e doreza pune.
- Vendosjen në vende të dukëshme të linjës teknologjike, të fikseve të zjarrit dhe të kutisë së ndihmës së shpejtë.

2. ZBATIMI I MASAVE TË MBROJTJES SË MJEDISIT NË TËRËSI QË LIDHET ME SHKARKIMET NË AJËR, UJË DHE TOKË SI DHE INTENSITETIN E ZHURMAVE DHE TË VIBRIMEVE. NË KUADËR TË KËTYRE MASAVE MUND TË PËRMENDIM:

- Krijimi i një regjimi të rreptë kontrolli mbi cilësinë e lëndëve të para dhe prodhimeve të realizuara, për të qënë me të gjithë treguesit e standarteve përkatës si dhe për të shmangur të gjitha mundësitë që mund të çojnë në dëmtimin dhe bërjen të papërdorshëm të tyre.
- Krijimi dhe ruajtja e vazhdueshme e kushteve higjeno-sanitare standarte si dhe e parametrave normal të mikroklimës në të gjitha ambjentet e punës.
- Kryerja e monitorimeve mbi shkarkimet në ajër dhe ujra, për të mbajtur vazhdimisht nën kontroll nivelet e tyre në përputhje me standartet në fuqi.